



Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova

Statuti i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës

PREAMBULA

Liria e informimit është një ndër të drejtat themelore në çdo shoqëri demokratike dhe bazë për t'u mundësuar njerëzve të marrin pjesë në mënyrë aktive në institucionet demokratike dhe në opinionin shoqëror dhe politik si dhe në proceset vendimmarrëse.

Mediat e shkruara, si media më të vjetra, luajnë një rol të rëndësishëm duke u siguruar qytetarëve informata të rëndësishme, të sakta dhe të paanshme.

Mediat e shkruara, portalet e lajmeve, gazetatat dhe agjencitë e lajmeve, redaktorët e gazetarët e tyre, kanë detyrë të veçantë që të përmbushin nevojat e shoqërisë për t'u informuar, të mbrojnë të drejtat themelore njerëzore të secilit person, si dhe të respektojnë të vërtetën.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës është trup vetërregullues i mediave të shkruara për të siguruar që këto vlera dhe Kodi i Mediave të Shkruara të Kosovës të aplikohen në mënyrë të barabartë dhe në të mirë të shoqërisë dhe të qytetarëve të saj.

NENI 1 – FUSHA E VEPRIMTARISË

Këshilli i Mediave të Shkruara është organizatë joqeveritare e regjistruar e mediave të shkruara të Kosovës, ku bëjnë pjesë gazetatat e përditshme, portalet e lajmeve, gazetatat periodike, revistat dhe agjencitë e lajmeve (në tekstin e mëtejshëm: Mediat e Shkruara) që garanton:

- Zbatimin e Kodit të Mirësjelljes së Mediave të Shkruara të Kosovës nga të gjithë anëtarët e saj dhe jo anëtarët;
- Përcjelljen e zbatimit të standardeve për gazetarinë e shkruar në Kosovë;

- Angazhimin për lirinë e shtypit dhe informimit të lirë;
- Udhëheqjen me pasurinë e vet, të luajtshme dhe të paluajtshme;
- Bashkëpunimin me organizatat e mediave në vend dhe ato ndërkombëtare.

NENI 2 – EMRI, VENDI

- (1) Këshilli i Mediave të Shkruara është organizatë joqeveritare e bazuar në definicionin e paragrafit 5.2 të Ligjit për Lirinë e Asocimit në Organizatat Joqeveritare 12/02/2009, No. 03/L-134, e cila implementon Statutin, Kodin e etikës, Rregullat e procedurës dhe legjislacionin.
- (2) Emri i plotë i KMSHK-së është: Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës/Press Council of Kosovo/Savet Štampe Kosova (duke iu referuar si “Këshilli i Medieve të Shkruara”).
- (3) Selia e Këshillit të Mediave të Shkruara është në Prishtinë, Republika e Kosovës.
- (4) Viti fiskal është i njëjtë me vitin kalendarik.

NENI 3 – QËLLIMET

- (1) Këshilli i Mediave të Shkruara promovon dhe zbaton Kodin e Mediave të Shkruara të Kosovës.
- (2) Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës shqyrton ankesat lidhur me shkeljet e Kodit të Mediave të Shkruara nga ana e mediave të shkruara të Kosovës.
- (3) Këshilli i Mediave të Shkruara vendos për masat nëse ankesa konsiderohet të jetë e arsyetuar.
- (4) Anëtarët e Këshillit të Mediave të Shkruara veprojnë në mënyrë të pavarur. Përfaqësuesi i Medias së Shkruar, rasti i të cilit shqyrtohet, nuk ka të drejtë të votojë dhe duhet ta lëshojë mbledhjen gjatë votimit.
- (5) Mediat anëtare të Këshillit të Mediave të Shkruara publikojnë pa pagesë vendimet e Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës.
- (6) Anëtarët e Këshillit të Mediave të Shkruara publikojnë pa pagesë informatat për Kodin e Mediave të Shkruara si dhe për Procedurën e Ankesës, nëse Anëtarët e Kuvendit e kërkojnë këtë gjë.

NENI 4 – ANËTARËSIMI

- Anëtarë të Këshillit të Mediave të Shkruara janë nënshkruarit e këtij Statuti, respektivisht mediat e shkruara të Kosovës të përfaqësuara nga kryeredaktorët e mediave të shkruara të Kosovës, apo të deleguarit e tyre.
- (1) Mediat bëhen anëtarë të KMSHK-së pasi t'i kenë plotësuar kushtet në vijim:
 - Anëtari duhet të jetë nga fusha e mediave;
 - Regjistrimi i anëtarëve bëhet në përputhje me dispozitat ligjore;
 - Anëtari ofron të gjitha informatat e nevojshme, si emrin i themeluesit/esve, emrat e stafit menaxhues (kryeredaktorit dhe redaktorit), e-mailin, numrin e telefonit, dhe adresën;
 - Anëtari e dorëzon kopjen e regjistrimit të biznesit apo të regjistrimit të organizatës të bëra konform dispozitave të ligjeve në fuqi;
 - Anëtari publikon impresumin;
 - Anëtari nënshkruan Kodin e Mediave të Shkruara të Kosovës dhe Statutin e Këshillit të Mediave të Shkruara;
 - Një anëtar e përfaqëson një medium edhe nëse i njëjti i përfshin disa njësi brenda vetes.
 - (2) Vendimin për anëtarësim të mediave e merr Kuvendi i KMSHK-së me shumicë votash të anëtarëve prezentë.
 - (3) Këshilli i Mediave të Shkruara është i hapur për të gjitha mediat e shkruara në Kosovë.
 - (4) Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, gjithashtu merr në shqyrtim edhe ankesat që i drejtohen kundër mediave të shkruara joanëtare. Në këto raste, KMSHK nxjerr publikisht opinion lidhur me ankesën ndaj medias së shkruar, joanëtare e KMSHK-së. Procedura për shqyrtim dhe nxjerrje të opinionit parashikohet në Rregullat e Procedurës.
 - (5) Anëtarësimi i mediave të shkruara në KMSHK përfundon përmes njoftimit me shkrim, që i dërgohet kryetarit të Kuvendit dhe me afat paralajmërimi prej një muaji, apo me anë të përjashtimit.
 - (6) Anëtarësimi i tre anëtarëve të pavarur përfundon pas skadimit të mandatit apo pas dorëheqjes së tyre.

NENI 5 – GRUPET

Këshilli i Mediave të Shkruara përbëhet nga Kuvendi i anëtarëve të Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës dhe nga Sekretaria.

NENI 6 – KUVENDI

A. Përbërja

- (1) Kuvendi përbëhet nga përfaqësuesit e mediave të shkruara të anëtarësuar – kryeredaktorët apo të deleguarit e tyre, si dhe nga tre anëtarë të pavarur, të cilët kryejnë funksionin e kryetarit dhe të nënkryetarëve.
- (2) Kuvendi ka një kryetar, një nënkryetar të parë, dhe një nënkryetar të dytë. Kryetari dhe nënkryetarët zgjidhen me mandat dyvjeçar. Personi i njëjtë nuk mund të rizgjidhet më shumë se një herë.
- (3) Mediat anëtare të Kuvendit zgjedhin kryetarin dhe dy nënkryetarët me shumicë të thjeshtë votash.
- (4) Nënkryetari i dytë preferohet të jetë pjesëtar nga grupet minoritare.
- (5) Takimet udhëhiqen nga kryetari, ndërsa në mungesë të tij nga nënkryetari i parë, apo kur të dy mungojnë, nga nënkryetari i dytë i Kuvendit.
- (6) Kuvendi mund të nxjerrë vendime kur shumica e thjeshtë e anëtarëve është e pranishme në mbledhje. Për ndryshim të Statutit, shpërbërje të Kuvendit apo përjashtim të një mediumi anëtar që nuk i përmbush detyrimet nga vendimet e Këshillit të Mediave të Shkruara nevojitet një shumicë prej 2/3 të anëtarëve prezentë.
- (7) Anëtarët votojnë për apo kundër. Nuk lejohet abstenimi.
- (8) Kuvendi i Anëtarëve takohet çdo muaj. Kryetari dhe 1/3 e anëtarëve mund të thërrasin mbledhje të jashtëzakonshme.
- (9) Anëtarëve të Kuvendit u paguhet mëditje për çdo pjesëmarrje në mbledhje.

B. Përgjegjësitë

Kuvendi i anëtarëve

- (1) Është mbrojtës i Kodit të Mediave të Shkruara dhe akteve të tjera normative, të cilat Kuvendi mund t'i amandamentojë dhe fuqizojë.
- (2) Vendosë për rregullat e procedurës.
- (3) Vendosë për buxhetin vjetor dhe aprovon raportin financiar në fund të secilit vit fiskal.
- (4) Emëron drejtorin ekzekutiv dhe zyrtarin për ankesa të Sekretarisë dhe vendosë për kushtet e kontratës së tyre.
- (5) Vendosë për validitetin e ankesës.
- (6) Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës përfaqësohet nga kryetari i Kuvendit dhe drejtori ekzekutiv. Në mungesë të tyre, KMSHK përfaqësohet nga nënkryetarët.
- (7) Takimet e Kuvendit janë publike, posaçërisht për vëzhguesit e mediave, përveç nëse Kuvendi vendosë ndryshe.
- (8) Kuvendi ka kompetenca të urdhërojë mediumin përkatës të botojë ose të paraqesë në uebfaqe vendimin e marrë nga Kuvendi.
- (9) Kuvendi ka kompetenca të përfundojë anëtarësimin e secilit medium të shkruar, që nuk përfill vendimet e tij.
- (10) Kuvendi ka kompetenca të përjashtojë një medium nga anëtarësimi i tij me 2/3 të votave të pjesëmarrësve në Kuvend.

NENI 7 – SEKRETARIA

Përbërja

- (1) Sekretaria përbëhet nga një drejtor, i punësuar me orar të plotë pune, dhe një zyrtar për ankesa, po ashtu me orar të plotë pune.
- (2) Drejtori ekzekutiv dhe stafi janë të pavarur nga ndikimi partiak dhe politik.
- (3) Drejtori dhe zyrtari për ankesa zgjidhen dhe emërohen nga Kuvendi i anëtarëve, ndërsa të tjerët përzgjidhen nga drejtori ekzekutiv në konsultim me kryetarin e Kuvendit me një konkurs publik.
- (4) Kontrata e drejtorit ekzekutiv nënshkruhet nga kryetari i Kuvendit.

- (5) Kontratat e stafit nënshkruhen nga drejtori ekzekutiv dhe kryetari i Kuvendit.

Funksionet

Sekretaria dhe stafi i saj:

- (1) Janë përgjegjëse për punët administrative të Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës dhe sigurojnë qarkullim korrekt dhe transparent të informatave si dhe korrespondencën në mes paditësve dhe mediave të shkruara.
- (2) Përgatisin raportin financiar dhe propozojnë buxhetin për Kuvendin e anëtarëve.
- (3) Përgatisin draft rregullat për procedurën e ankesës.
- (4) Zbatojnë vendimet e Kuvendit.
- (5) Sekretaria shqyrton se a janë plotësuar kushtet formale nëse një ankesë mund të hyjë në procedurë për shqyrtim.
- (6) Sekretaria refuzon ankesën nëse nuk janë plotësuar kushtet e nevojshme sipas Statutit dhe Rregullave të procedurës.
- (7) Sekretaria zhvillon procesin e ndihmës dhe mbështetjes profesionale midis ankuesit dhe medias kundër së cilës është drejtuar ankesa dhe me shkrim e njofton Kuvendin për veprimet e ndërmarra.
- (8) Sekretaria përgatitë propozimet e vendimeve për Kuvendin.
- (9) Sekretaria nuk ka të drejtë vote në vendimmarrjet e Kuvendit.
- (10) Kryejnë detyra të tjera sipas udhëzimeve të Këshillit.

NENI 8 – FINANCIMI

- (1) Mediat e shkruara të anëtarësuar kontribuojnë financiarisht në buxhetin e Këshillit të Mediave të Shkruara.
- (2) Për çdo vit ky kontribut është 300 euro për të gjithë anëtarët e Këshillit të Mediave të Shkruara. Kjo shumë mund të realizohet edhe me heqje dorë nga mëditjet që merren me pjesëmarrje në takimet e Kuvendit.
- (3) Kontributi mund të paguhet jo më vonë se deri në fund të qershorit të secilit vit.

- (4) Të hyrat e KMSHK-së krijohen nga kontributi i anëtarëve, donacionet dhe format e tjera të ligjshme.

NENI 9 – PROCEDURAT

- (1) Kuorumi i Kuvendit krijohet me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës.
- (2) Kuorumi përfshin kryetarin e Kuvendit; në mungesë të tij, mbledhja udhëhiqet nga njëri nënkryetar.
- (3) Të gjitha votimet e kryera nga Kuvendi i Anëtarëve përfillin rregullat e votimit të fshehtë të shumicës së atyre që janë të pranishëm, përveç nëse përcaktohet ndryshe në këtë Statut. Nëse nuk arrihet shumica, atëherë kryetari i Kuvendit ose nënkryetari i Kuvendit, në mungesë të tij, e ka të drejtën e votës vendimtare.
- (4) Këshilli i Mediave të Shkruara i përcakton dhe i bën publike procedurat e ankesave. Këto janë pjesë shtojcë e këtij Statuti.
- (5) Çdo banor i Kosovës, i definuar në bazë të Kushtetutës dhe ligjit, posaçërisht ai që ndihet i fyer, ka të drejtë të paraqesë ankesë.
- (6) Ky Statut mund të ndryshohet vetëm me 2/3 të shumicës së anëtarëve të Kuvendit.
- (7) KMSHK mund të shpërbëhet vetëm me vendim të 2/3 të anëtarëve të Kuvendit. Çdo vlerë (pasuri) që mbetet pas shkarkimit të përgjegjesisë së KMSHK-së duhet t'u shpërndahet trupave që do të përcaktohen nga Kuvendi.
- (8) Ky Statut është në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht.
- (9) Versioni në gjuhën shqipe është bazë.
- (10) Ky Statut hyn në fuqi më 10 gusht 2005.
- (11) Ky Statut është plotësuar më 26 janar 2010 dhe është miratuar nga anëtarët, sipas procedurës së paraparë në Statut. Neni 4 pika 2 është amendamentuar më datën 26 shkurt 2013.

Ky Statut u amendamentua në qershor të vitit 2016.